

VENDIM
Nr. 844, datë 14.10.2015

**PËR HEQJEN NGA FONDI KULLOSOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES NË
NGASTRAT E EKONOMISË KULLOSORE “MALI I RENCIT-KAKARRIQ”,
BALLDRE, NË LEZHË, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “COLACEM
ALBANIA” SHPK, PËR SHFRYTËZIMIN E GURIT GËLQEROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Sipërfaqja në nënngastrat 15a, 15b dhe 15c të ekonomisë kullorë “Mali i Rencit-Kakarriq”, Balldre, Lezhë, gjithsej 95.00 ha, që do të përdoret nga shoqëria “Colacem Albania” sh.p.k., për shfrytëzimin me karrierë të gurit gëlqeror në vendburimin “Mali i Kakarriqit”, të hiqet nga Fondi Kullor Kombëtar dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Vlera e sipërfaqes së hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga subjekti “Colacem Albania” sh.p.k., sipas tarifave të miratuara me vendimin nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të Fondit Kullor Kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqes së këtyre ngastrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bën çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë kullotë” dhe e regjistron në “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi me karrierë të gurit gëlqeror”.

Subjekti “Colacem Albania” sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë, sipas kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore dhe të përmirësojë me fondet e veta një sipërfaqe kullorë prej 190 ha në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

Sipërfaqja kullorë, sipas lidhjes 1 të këtij vendimi, mbetet pronë publike e shtetit dhe regjistrohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit sipas lejes mjedisore nga shoqëria “Colacem Albania” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullor publik.

Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, komuna Balldre e zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe subjekti “Colacem Albania” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela 1

Sipërfaqet që do të hiqen nga fondi kullor sipas përdorimit të territorit dhe pronësisë

Nr	Emërtimi i ekonomisë	Ngastra	Sip. që do hiqet (ha)	Përdorimi territorit	Qeverisja	Funksioni kryesor	Pronësia
1	Mali i Rencit-Kakarriq	15/a	46.68	kullotë	kullotë	kullotë	Komuna Balldre
2	Mali i Rencit-Kakarriq	15/b	17.32	kullotë	kullotë	kullotë	Komuna Balldre
3	Mali i Rencit-Kakarriq	15/c	31	kullotë	kullotë	kullotë	Komuna Balldre
TOTALI			95				

HARTA TOPOGRAFIKE ME KOORDINATAT E ZONES SE KERKUAR PER LEJE SHFRYTEZIMI
Ghikalla 1:25000



ZONA E KËRKUAR PËR LEJË SHFRYTEZIM "CETAKU ALBANI"
 Raportim i Afërs
 Koordinatat e pikave

pika	x	y	pika	x	y
1	4.384.604,45	4.637.102,35	15	4.385.288,51	4.634.780,19
2	4.384.590,00	4.636.000,00	17	4.385.512,27	4.634.763,77
3	4.385.071,00	4.636.346,00	18	4.385.344,28	4.634.755,70
4	4.384.835,00	4.636.200,00	19	4.385.375,91	4.634.726,19
5	4.385.183	4.635.802	20	4.385.400,62	4.634.711,84
6	4.385.398	4.635.567	21	4.385.468,25	4.634.706,59
7	4.385.569	4.635.744	22	4.385.476,46	4.634.699,38
8	4.385.003	4.635.310	23	4.385.485,48	4.634.690,10
9	4.385.816	4.635.331	24	4.385.575,02	4.634.588,15
10	4.385.875,00	4.635.115,00	25	4.385.547,57	4.634.575,69
11	4.386.046,00	4.635.153,00	26	4.385.605,78	4.634.426,44
12	4.386.137,75	4.634.975,54	27	4.385.773,35	4.634.422,18
13	4.386.194,75	4.634.880,74	28	4.385.545,00	4.634.340,00
14	4.386.153,36	4.634.836,65	29	4.384.715,00	4.634.470,00
15	4.386.203,49	4.634.824,00	30	4.384.337,23	4.634.882,65